



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 03 shtator 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

Miratoi ndryshimet në Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e Gazit Natyror, miratuar me vendimin nr. 97, datë 04.07.2017. Ndryshimet përditësojnë kuadrin e licencimit dhe përfshijnë rregullime të posaçme për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së dhe GNK-së me përmasa të vogla.

Miratoi Licencat TIP për operimin në impiantet e GNL-së dhe GNK-së me përmasa të vogla.

U miratuan kërkesat e shoqërive “GREENSOL” sh.p.k. dhe “GERTI” sh.p.k. për përfshirjen dhe operimin e sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike në kuadër të licencave për prodhimin e energjisë elektrike.

- Për “GREENSOL” sh.p.k., me vendndodhje në Njësitë Administrative Mesopotam dhe Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, u miratua përfshirja e veprave ndihmëse/njësie të depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës së prodhimit.

- Për “GERTI” sh.p.k., u miratua njohja dhe lejimi i operimit të sistemit të depozitimit të energjisë elektrike, në kuadër të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin e instaluar prej 10 MW të centralit fotovoltaiik.

Për sistemet e depozitimit të energjisë elektrike të përfshira në licencat ekzistuese, e drejta e operimit mbetet e vlefshme deri në përfundim të periudhës së përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, subjektet përkatëse duhet të aplikojnë pranë ERE-s për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit.

Miratoi ndryshimin e vendimit nr. 68, datë 08.04.2025, të ndryshuar, për shoqërinë “RENEW” sh.p.k., Ndryshimi u miratua pas përmbushjes së kushtit të përcaktuar më parë nga ERE për stafin teknik. Në vijim, bazuar në kontratën e re të operimit dhe mirëmbajtjes, u përcaktua që informacioni i përditësuar mbi stafin teknik të depozitohet në ERE brenda datës 01.08.2028.

Vendosi pezullimin e procedures administrative te shqyrtimit te kerkeses se shoqerise KESH sh.a. për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese “Tigri 1”, me kapacitet 50 MW, dhe “Tigri 3”, me kapacitet 60 MW, në Portin e Triportit, Gjiri i Vlorës,. Pezullimi do të vijojë deri në sqarimin nga AKM të vlefshmërisë së lejeve mjedisore për operimin e këtyre TEC-eve, pas të cilit procedura administrative do të rifillojë.

Në këtë mbledhje u shqyrtua dhe raportimi i OST sh.a. mbi situatën operative të rrjetit të transmetimit dhe masat e ndërmarra për përballimin e sezonit turistik. Gjatë muajit korrik 2026, konsumi i energjisë elektrike u rrit me 3.67%, ndërsa ngarkesa maksimale e sistemit arriti në 1,474 MW, rreth 8% më shumë se në korrik 2025.

Nga raportimi rezultojnë disa kufizime dhe pika me risk operacional, kryesisht në Vlorë 2, Pogradec dhe në linjën 220 kV Fier–Hoxharë, për të cilat OST ka parashikuar masa operative dhe kompensuese. Masat e ndërmarra dhe ato që vijojnë gjatë sezonit përfshijnë mirëmbajtjen dhe inspektimin e aseteve, gatishmërinë e ekipeve të emergjencës, sigurimin e rezervave materiale, shmangien e ndërprerjeve të planifikuara dhe koordinimin ndërinstitutional.

ERE do të vijojë monitorimin e situatës dhe efektivitetit të këtyre masave gjatë sezonit veror.

Vendimet e plota të Bordit të ERE-s janë të aksesueshme në faqen zyrtare të ERE-s dhe publikohen në Fletoren Zyrtare, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.